



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje binderi (furnizim, vendosje) për shtrimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2026”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44113100-6
Materiale asfaltimi, (CPV): 14213100-8 Asfalt bitumi**

VLERA E FONDIT LIMIT: 45.832.639,58 (dyzetë e pesë milion e tetëqind tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë e pesëdhjetë e tetë të qindat) lekë pa Tvsh, nga të cilat: 5.832.639,59 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë e pesëdhjetë e nëntë të qindat) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë dhe 39.999.999,99 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë e nëntëdhjetë e nëntë të qindat) lekë pa Tvsh nga Granti.

Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

Për vitin 2026: 12.372.382,92 (dymbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e dy e nëntëdhjetë e dy të qindat) lekë pa Tvsh, nga të cilat: 5.832.639,59 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë e pesëdhjetë e nëntë të qindat) lekë pa Tvsh nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë dhe 6.539.743,33 (gjashtë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e tre e tridhjetë e tre të qindat) lekë pa Tvsh nga Granti.

Për vitin 2027: 15.543.590,00 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Granti.

Për vitin 2028: 17.916.666,66 (shtatëmbëdhjetë million e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë e gjashtëdhjetë e gjashtë të qindat) lekë pa Tvsh nga Granti.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 491.766,51 (katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje pesëdhjetë e një) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 06.08.2026 është: 93.20

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, Njësia e Prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, preventivin, si edhe në procesverbalin për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit, për tenderin me objekt: “*Blerje binderi (furnizim, vendosje) për shtrimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2026*”, mbajtur nga komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim, të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Konkretisht Njësia e Prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2023, 2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si edhe në nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/a citohet: dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se, operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në referencë, është bërë që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/a dhe pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**” i ndryshuar, si edhe në Ligjin Nr.29/2023, datë 30.03.2023 “**Për tatimin mbi të ardhurat**”. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit

Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/a, të Nenit 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 **“Për sistemin e taksave vendore”** i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe këstet e maturuara të vitit 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe këstet e maturuara të vitit 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...**”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Vendosija e kriterit të sipërcituar, është vënë për të patur një informacion sa më koherent, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore. Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, nenin 40, pika 8 dhe nenin 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”** i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 **“Për procedurat tatimore”** i

ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse, për vitin 2025 dhe kështu e maturuara të vitit 2026.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe në nenin 40, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të

ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë fabrikë asfaltobetonit në pronësi/qera ose kontratë furnizimi. Për të vërtetuar pronësinë e fabrikës së asfaltobetonit, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së asfaltobetonit (Faturë tatimore blerjeje ose Kontratë blerjeje, etj, si edhe Leje mjedisore tipi B me kod III.1.B lëshuar nga QKL). Për kontrata të qerasë ose të furnizimit, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse ose marrëveshjen e furnizimit me objekt dhe afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari** dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në nenin 40, pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si edhe në nenin 40, pika 5/ç të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pra, me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur*

kontratën. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK-së, për të siguruar se ofertuesit do ta realizojnë me sukses kontratën, sipas kërkesave të përcaktuara në DST, pasi bën të mundur dhe garanton, përputhshmërinë dhe rregullsinë e procesit të furnizimit, cilësinë e produktit, si edhe disponibilitetin e mallit me cilësinë e kërkuar, përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate, duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë ose të kontraktuar me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, inxhinierin e mëposhtëm:

i. Inxhinier ndërtimi 1 (një)

(Inxhinieri i sipërcituar, nëse figuron si drejtues teknik i shoqërisë, duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë, për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.)

Për inxhinierin e kërkuar duhet të paraqitet: Diploma dhe Kontratë individuale pune (e vlefshme).

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari** dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në pikën 5/b/c të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në Kodin e punës, si edhe në legjislacionin për sigurimet shoqërore. Vendosja e këtij kriteri për disponimin e punonjësve/personelit kryesor, është bërë në përputhje me objektin përkatës të prokurimit, me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e realizimit të kontratës përgjatë gjithë vlefshmërisë së saj, si edhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të tyre. Përllogaritja e fuqisë punëtore dhe

makinerive, është bërë bazuar në VKM-në Nr.216, datë 13.04.2023 **“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”** (sipas portalit SIM në e-albania), bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 i ndryshuar, si edhe bazuar në preventivin përkatës të procedurës së prokurimit. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e listëpagesës së muajit të fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, për inxhinierin e ndërtimit nëse figuron si drejtues teknik i shoqërisë, për arsye se duke pasur parasysh edhe parashikimin e nenit 11, shkronja a), të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003, **“Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar, ku parashikohet se deklaramet dhe pagesat e kontributeve bëhen: *“a) Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, **brenda datës 20 të muajit pasardhës.** Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër”*. Inxhinieri i ndërtimit kërkohet për arsye se, për një objekt të kësaj natyre teknike, është e domosdoshme përfshirja e një inxhinieri ndërtimi, që të mbikëqyrë zbatimin teknik të punimeve, të bëjë kontrollin e cilësisë së përbërjes dhe përhapjes së asfaltit, si edhe të sigurojë përputhshmërinë e tij me standartet e kërkuara. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve, është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje, është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Pra, ky kriter për kualifikim, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Inxhinier ndërtimi kërkohet për drejtimin teknik të punimeve, kontrollin e cilësisë së materialeve që do të përdoren, verifikimin e parametrave teknikë gjatë shtrimit të binderit, koordinimin e proceseve të furnizimit dhe vendosjes së materialit, si dhe për garantimin e zbatimit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet në fuqi.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në stafin e tij ose të kontraktuar me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, manovratorë të certifikuar sipas profesioneve, si më poshtë:

- Buldozeristë 2 (dy)
- Automakinist 1 (një)
- Shofer me leje drejtimi C 2 (dy)

(Punonjësit e sipërcituar, nëse figurojnë si të punësuar pranë shoqërisë, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë, për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.)

(Në rastin kur mjetet/makineritë disponohen me qera, drejtuesit e mjeteve/makinerive, mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të kontratës;
- Dokument (Dëshmi kualifikimi profesional, Certifikatë apo Dëshmi Aftësie Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin Nr.200, datë 16.05.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...**”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në pikën 5/b/c të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në Kodin e punës, si edhe në legjislationin për sigurimet shoqërore. Vendosija e këtij kriteri për disponimin e punonjësve/personelit kryesor, është bërë në përputhje me objektin përkatës të prokurimit, me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e realizimit të kontratës përgjatë gjithë vlefshmërisë së saj, si edhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të tyre. Përlllogaritja e fuqisë punëtore dhe makinerive, është bërë bazuar në VKM-në Nr.216, datë 13.04.2023 **“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”** (sipas portalit SIM në e-albania), bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 i ndryshuar, si edhe bazuar në preventivin përkatës të procedurës së prokurimit. Emërtimi i manovratorëve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr.200, datë 16.05.2019 **“Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”**. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e listëpagesës së muajit të

fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, për punonjësit e sipërcituar nëse figurojnë si të punësuar pranë shoqërisë, për arsye se duke pasur parasysh edhe parashikimin e nenit 11, shkronja a), të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003, “**Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë**”, i ndryshuar, ku parashikohet se deklaratimet dhe pagesat e kontributeve bëhen: “*a) Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër*”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve, është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje, është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Pra, ky kriter për kualifikim, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Buldozeristë – 2 (dy)

Kërkohen për operimin e makinerive të nevojshme për sistemin dhe përgatitjen e sipërfaqeve ku do të kryhet shtrimi i binderit. Numri prej 2 operatorësh është i nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e punës dhe për realizimin e ndërhyrjeve në disa segmente rrugore sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Automakinist – 1 (një)

Kërkohet për operimin e makinerive të përdorura gjatë procesit të shpërndarjes, nivelimit dhe sistemit të materialeve në terren, duke garantuar realizimin e punimeve sipas parametrave teknikë të kërkuar.

Shofer me leje drejtimi C – 2 (dy)

Kërkohen për transportin e binderit, emulsionit bituminoz dhe materialeve të tjera nga vendi i prodhimit deri në vendin e zbatimit të punimeve. Numri prej 2 shoferësh justifikohet nga sasia e konsiderueshme e materialit që do të transportohet shpërndarja e punimeve në disa njësi administrative dhe nevoja për të respektuar afatet e realizimit të kontratës pa ndërprerje të procesit të furnizimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në dispozicion, apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Lista e Makinerive:

Nr	Emërtimi i makinerisë	Specialist makinerish	Numri i makinerive	Statusi
1	Asfaltoshtuese	Buldozerist	1	Në pronësi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi
2	Autobitumatriçe	Automakinist	1	Në pronësi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi
3	Rul me kompresor	Buldozerist	1	Në pronësi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi
4	Mjete transporti vetëshkarkues mbi 25 ton	Shofer me leje drejtimi C	2	Në pronësi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi

1 (një) Asfaltoshtuese, e cila do të përdoret për shtrimin me asfalt të rrugëve urbane në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Divjakë.

1 (një) Autobitumatrice, e cila do të përdoret për spërkatjen me primer të rrugëve para hedhjes së asfaltit.

1 (një) Rrul me kompresor, i cili do të realizojë ngjeshjen e asfaltit të shtruar në rrugë.

2 (dy) Mjete transporti vetëshkarkues mbi 25 ton, të cilat do të përdoren për kryerjen e transportit të mallit në objekt.

=> Për mjetet që shënohen në regjistra publike (me goma) që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) çertifikatë transporti.

=> Për mjetet që shënohen në regjistra publike (me goma) që janë me qira, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) çertifikatë transporti.

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë lejen e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore.

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të

kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirasë, duhet të jenë leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dokument të vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publike, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.

Kosto e transportit duhet të financohet tërësisht nga operatori ekonomik, brenda çmimit të kontratës.

Për difekte të ndodhura në mjet gjatë punës, operatori ekonomik do të marrë përsipër riparimin e tyre me shpenzimet e veta.

Nëse procedura e riparimit të difektit, do të zgjasë më tepër se një ditë, periudha e difektit do të shtohet në zgjatjen e afatit të përdorimit të mjetit.

Mjetet, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shënim: Përlllogaritja e makinerive është bërë bazuar në VKM-në Nr.216, datë 13.04.2023 **“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”** (sipas portalit SIM në e-albania).

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfaqësohen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...**”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 5/ç të VKM

Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.* Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion, apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kërkohen mjetet e sipërcituara, për shkak të distancave të gjata të kryerjes së punimeve dhe sasisë së konsiderueshme të mallit të kërkuar për tu ezauruar si sasi totale brenda afatit të përcaktuar në grafikun e lëvrimit të mallit, si edhe të përfitimit të kohës për realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara. Mjetet e kërkuara, janë vendosur në proporcion me volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Numri dhe lloji i makinerive në pronesi/qira, janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të mjeteve, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Mjetet e mësipërme, janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit ofertues, për përmbushjen me sukses të kontratës. Pra, këto mjete, nevojiten për realizimin e shërbimeve të nevojshme, sipas funksionit përkatës që ka secili mjet, konform punimeve që do të kryhen sipas kohëzgjatjes së tyre.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të cilës, duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë furnizimin, shërbimin e transportit të mallit të kërkuar dhe vendosjen e tij në objekt, sipas grafikut të lëvrimit të mallit dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe në nenin 40, pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Pra, me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatori ekonomik pjesëmarrës, të dëshmojë me anë të deklaratave, për të garanuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë Autoritetit Kontraktor, që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë se, mallrat e ofertuara janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si edhe në nenin 40, pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* Vendosija e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Pra, me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatori ekonomik pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të vërtetojë dhe garantojë AK, se mallrat e ofertuara, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Materiali Binder me gur kave dhe emulison bitumi do të përdoret për shtrimin dhe sistemimin e rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë.

1- Klasifikimi i asfaltobetonit

Te Pergjithshme

- a) Asfaltobetoni për ndërtimin e shtresave rrugore përgatitet nga përzierja në të nxehtë e materialeve mbushës (çakëll, granil, rërë e pluhur mineral) me lëndë lidhëse bitum.
- b) Sipas madhësisë ose imtësisë të kokrrizave të materialit mbushës, që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit, ai klasifikohet:
 - asfaltobeton kokërrmadh me madhësi kokrrize deri 35 mm.
 - asfaltobeton mesatar me madhësi kokrrize deri 25 mm.
 - asfaltobeton i imët me madhësi kokrrize deri 15 mm.
 - asfaltobeton ranor me madhësi kokrrize deri 5 mm.
- c) Në varësi nga poroziteti që përmban masa e asfaltobetonit në gjëndje të ngjeshur ndahet:
 - Asfaltobeton i ngjeshur, i cili përgatitet me çakëll të thyer e granil në masë 35 deri 40%, rërë 50% dhe pluhur mineral 5 deri 15% dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës në masën 3 deri në 5% në volum.
 - Asfaltobetoni poroz (binder) që përgatitet me 60 deri 75% çakëll të thyer, 20 deri në 35% rërë dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës 5 deri 10% në vëllim.
- d) Asfaltobetoni i ngjeshur përdoret në ndërtimin e shtresës përdoruese, ndërsa asfalto betoni poroz për shtresën lidhëse (binder).
- e) Asfaltobetoni i ngjeshur në varësi nga përmbajtja e pluhurit mineral e shprehur në përqindje në peshë dhe të cilësive të materialeve përbërës të tij, klasifikohen në dy kategori:
 - Kategoria I me përmbajtje 15% pluhur mineral
 - Kategoria II me përmbajtje 5% pluhur mineral

Kërkesat teknike ndaj materialeve përbërës të asfaltobetonit.

- a) Bitumi që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit si dhe në asfaltimet e tjera me depërtim ose trajtim sipërfaqësor, duhet të plotësojë kërkesat e Stash 660-87 ose të STASH CNR Nr. 1996 “Karakteristika për pranim”.
- b) Në kohë të nxehtë (verë) keshillohet përdorimi i bitumit me depërtim (penetrim) 80 deri 120 ose me pikë zbutje 45 deri 50⁰C, ndërsa në pranverë e vjeshtë bitum me depërtim 120 deri 200 ose pikë zbutje 40 deri 45⁰C.
- c) Çakëlli, zalli, zalli i thyer dhe granili duhet të plotësojnë kërkesat e STASH 539- 87 “Përpunime ndërtimi”.
- d) Rezistenca në shtypje e shkëmbinjve nga të cilët prodhohet me copëtim mekanik çakëlli e granili, duhet të jetë jo më pak se 800kg/cm². Këshillohet që:

- e) Për shtresën përdoruese, rezistenca në shtypje e shkëmbinjve të jetë mbi 1000 kg/cm^2 .
- f) Zalli i thyer duhet të përmbajë jo më pak se 35% kokrriza të thyera me madhësi mbi 5mm. Sasia e kokrrizave të dobëta (me rezistencë më pak se 800 kg/cm^2) nuk duhet të jetë më shumë se 10% në peshë, për kategorinë e parë të asfaltimit dhe jo më shumë se 15% në peshë për kategorinë e dytë të asfaltimit. Sasia e kokrrizave në formë pete dhe gjilpërë, të mos jetë me shume se 25% në peshë për shtresën lidhëse (binder).
- a) Rëra për prodhim asfaltobetonit mund të përfitohet nga copëtimi dhe bluarja e shkëmbinjve me rezistencë në shtypje mbi 800 kg/cm^2 , ose nga lumi dhe në çdo rast, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 506-87 “Rëra për punime ndërtimi”.
- b) Për përgatitjen e asfaltobetonit ranor, ajo duhet të jetë e trashë me modul mbi 2.4.
- c) Pluhuri mineral që përdoret për prodhim asfaltobetonit, mund të përfitohet nga bluarja e shkëmbinjve gëlqerorë ose pluhur TCC, çimento, etj. Në çdo rast pluhuri mineral duhet të plotësojë kërkesat lidhur me imtësinë dhe hidrofilitetin.
- d) Imtësia e pluhurit mineral duhet të jetë e tillë, që të kalojë 100% në sitën me madhësi të vrimave 1.25 mm dhe të kalojë jo më pak se 70% në peshë në sitën 0.074 mm.
- e) Koeficienti i hidrofilitetit të pluhurit mineral, i cili shpreh aftësinë lidhëse me bitumin të jetë jo më shumë se 1.1

Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit

- a) Asfaltobetonit përgatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të ngrihen sa më afër depozitave të lëndëve të para dhe vendit të përdorimit të tij. Aftësia prodhuese e fabrikes përcaktohet në varësi nga plani i organizimit të punës së firmës, që zbaton punimet e ndërtimit të rrugës.
- b) Materialet mbushës të asfaltobetonit siç janë çakëlli, zalli, granili e rëra duhet të depozitohen pranë fabrikës në bokse të veçanta. Para futjes së tyre në përzierës ato duhet të thahen dhe nxehen deri në temperaturën 250°C , pastaj dozohen dhe futen në përzierës.
- c) Pluhuri mineral duhet të ruhet në depo të mbuluara dhe pa lagështi. Në çastin e dozimit dhe futjes në përzierës, ai duhet të jetë i shkrifët (i patopëzuar) dhe i thatë. Kur përmban lagështi duhet të thahet paraprakisht dhe futet në gjendje të nxehtë në përzierës.
- d) Bitumi, në prodhimin e asfaltobetonit futet në gjendje të nxehtë, por temperatura e tij nuk duhet të jetë mbi 170°C për ta mbrojtur nga djegia.

- e) Në fillim futen në perzierës materialet mbushës dhe pluhuri mineral, përzihen sëbashku në gjendje të thatë e të nxehtë, pastaj i shtohet bitumi po në gjendje të nxehtë dhe vazhdon përzierja derisa të krijohet një masë e njëtrajtshme.
- f) Dozimi i perbërësve të asfaltobetonit duhet të bëhet me saktësi $\pm 1.5\%$ në peshë për pluhurin mineral dhe bitumin me saktësi $\pm 3\%$ në peshë për materialet mbushëse të çfarëdo lloji, madhësie.
- g) Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë 140 deri 160⁰C. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri në 10⁰C, kufiri më i ulët i asfaltobetonit do të jetë jo më pak se 150⁰C.
- h) Transporti i asfaltobetonit duhet të bëhet me mjete vetëshkarkuese. Karrocëria e tyre para ngarkesës duhet të jetë e pastër, e thatë dhe e lyer me përzieres solari të holluar me vajgur, për të mënjeluar ngjitjen e masës së asfaltobetonit. Këshillohet që karrocëria e mjetit të jetë e mbuluar, për të mbrojtur asfaltobetonin nga lagështia dhe të ngadalësojë shpejtësinë e ftohjes së masës gjatë transportit.
- i) Automjeti që transporton asfaltobeton duhet të shoqërohet me dokumentin e ngarkesës, ku duhet të shënohen: targa e automjetit, lloji dhe sasia e asfaltobetonit, temperatura e masës në nisje dhe koha e nisjes e automjetit me ngarkesë nga fabrika.
- j) Kontrolli mbi cilësinë e asfaltobetonit bëhet në përputhje me kërkesat e STASH 561-87.
- k) Mostrat për kontrollin cilësor të prodhimit nxirren nga 3 deri 4 përzierje gjatë shkarkimit të masës së asfaltobetonit në automjet, duke veçuar 8 deri në 10kg nga çdo përzierje. Sasia e veçuar përzihet deri sa ajo të bëhet e njëtrajtshme dhe prej saj merret mostër mesatare me sasi 10kg. Mbi këtë mostër mesatare kryhen provat në laborator për përcaktimin e treguesave fiziko-mekanike, të cilët krahasohen me kërkesat e projektit ose STASH 660-87 për vlerësimin cilësor të prodhimit.
- l) Kontrolli mbi cilësinë e prodhimit të asfaltobetonit duhet të kryhet sa herë dyshohet nga pamja gjatë shkarkimit të përzierjes në automjet dhe në çdo rast jo më pak se një herë në turn.
- m) Kontrolli mbi cilësinë e prodhimit mund të bëhet edhe me metoda praktike duke u nisur nga pamja dhe punueshmëria e masës së asfaltobetonit gjatë vendosjes në vepër siç janë rastet e mëposhtme:
 - m-1) Asfaltobetoni që përmban bitum brenda kufirit të lejuar është i butë, shkëlqen dhe ka ngjyrë të zezë. Formon mbi karrocërinë e mjetit një kon të rrafshët dhe nuk fraksionohet gjatë shkarkimit. Kur përmban më shumë bitum, masa shkëlqen shumë, ngarkesa në karrocërinë e mjetit rrafshohet, gjatë shkarkimit bitumi rrjedh nga kokrrizat, llaçi del në sipërfaqe dhe shtresa rrudhoset gjatë ngjeshjes me rul. Kur përmban më pak bitum, masa e asfaltobetonit ka ngjyrë kafe, fraksionohet gjatë shkarkimit dhe kokrrizat e mëdha janë të pambështjella

mirë me bitum dhe janë të palidhura me njëra-tjetrën.

- m-2) Asfaltobetonit që ka temperaturë brenda kufirit të lejuar ($140 - 160^{\circ}\text{C}$) lëshon avull në ngjyrë jeshile dhe mjedisi sipër tij ngrohet. Kur temperatura është shumë e lartë, avulli ka ngjyrë blu te fortë. Kur temperatura është shumë e ulët, mbi masën e asfaltobetonit të ngarkuar në automjet formohet kore dhe mbas shkarkimit nuk avullon. Nuk realizohet ngjeshja e kërkuar dhe mbi sipërfaqen e shtresës së porsashtruar dallohen kokrrizat të palidhura mirë.
- m-3) Asfaltobetonit që përmban granit më shumë se kufiri i lejuar, shkëlqen shumë e fraksionohet gjatë ngarkim shkarkimit dhe në sipërfaqen e shtresës së porsashtruar dallohen zona me kokrriza të palidhura mirë. Kur përmban granit më pak se kufiri i lejuar, masa është pa shkëlqim, ka ngjyrë kafe dhe sipërfaqja e shtresës së porsashtruar është shumë e lëmuar.
- m-4) Kur masa e asfaltobetonit lëshon avull me ngjyrë të bardhë, tregon se tharja në baraban e materialeve mbushës nuk është bërë e plotë dhe ato përmbajnë akoma lagështi.
- n) Kur vërehen mangësi si ato të përshkruara në paragrafin m (pika m-1; m-2; m-3; dhe m-4) nuk duhet lejuar vazhdimi i punës për shtrimin e asfaltobetonit dhe të njoftohet menjëherë baza e prodhimit për të bërë korrigjimet e nevojshme në recetën e prodhimit.

4.3.1 Shtrimi dhe ngjeshja e asfaltobetonit

- a) Ndërtimi i mbulesës rrugore fillon të kryhet mbasi të kenë përfunduar punimet e themelit (nënshtresës) dhe të jenë treguesit teknik lidhur me ngjeshmërinë ose aftësinë mbajtëse të tyre në përputhje me kërkesat e projektit.
- b) Tipi i mbulesës rrugore me një ose më shumë shtresa, lloji i asfaltobetonit dhe trashësia e çdo shtrese në veçanti, përcaktohen nga projektuesi në projektin e zbatimit.
- c) Në ndërtimin e autostradave dhe rrugëve të Kat. I e të II, themeli (nënshtresa) duhet të jetë shtresë asfalti, shtresë makadami ose shtresë çakëlli, të cilat në çdo rast duhet të jenë të përcaktuara në projektin e zbatimit.
- d) Themeli (nënshtresa) mbi të cilën vendosen shtresat e asfaltobetonit, duhet të jetë e thatë dhe e pastër. Koha më e përshtatshme për shtrimin e asfaltobetonit është stina e pranverës, verës dhe vjeshtës. Megjithatë, në ditët me reshje shiu nuk lejohet.
- e) Shtrimi i asfaltobetonit duhet të fillojë nga njëra anë e rrugës (buzina) e deri në mesin e saj, duke ecur paralel me aksin gjatësor, për një segment rruge të caktuar, e cila zakonisht mund të jetë deri në 60m, më pas vazhdohet në segmentin tjetër e kështu me rradhë.
- f) Shtrimi i asfaltobetonit, sidomos në shtrimin e autostradave dhe rrugët e Kat. I e të II duhet të bëhet me makina asfaltoshtuese, të cilat sigurojnë shpërndarje të njëtrajtshme të masës së asfaltobetonit. Shpejtësia e lëvizjes së makinës asfaltoshtuese duhet të jetë 2 deri 2.5

km/orë.

- g) Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit (në gjendje të shkrifët) duhet të jetë 1.20 deri 1.25% më shumë nga trashësia e dhënë në projektzbatim në gjendje të ngjeshur.
- h) Temperatura e masës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë duhet të jetë në kufijtë 130 deri 150⁰C. Në kohë të nxehte jo më pak se 130⁰C dhe në kohë të ftohtë (kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri ne 10⁰C) të jetë jo më pak se 140⁰C.
- i) Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit duhet të kryhet menjëhere mbas shtrimit të tij në rrugë. Cilindri ngjeshës mund të ndjekë nga pas makinerinë asfaltoshtruese duke qëndruar në largësi deri 4m, me qëllim që ngjeshja të kryhet në gjëndje sa më të nxehtë.
- j) Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit per gjysmën e parë të rrugës fillon nga buzina (bankina), ndërsa për gjysmën tjetër nga fuga gjatësore, e cila mund të jetë aksi i rrugës.
- k) Makineritë që përdoren për ngjeshjen e shtresave të asfaltobetonit mund të jenë rula të zakonshëm me pesha të ndryshme nga 5 deri në 12 ton ose rulo me vibrim.
- l) Kur përdoren për ngjeshje rula të zakonshem, numri i kalimeve luhatet në kufij 12 deri 17, ndërsa kur përdoren rula vibrues, numri i kalimeve ulet ne masen deri 50%.
- m) Në fillim të ngjeshjes, cilindri në kalimet e para (deri 4 kalime) duhet t'a bëjë në të gjithë sipërfaqen e shtresës së asfaltobetonit duke ecur me shpejtësi 2 deri ne 2.5km/orë. Drejtimi i lëvizjes në kalimet e para këshillohet të bëhet në drejtim të cilindrit të parmë, me qëllim që të mënjanohet rrudhosja e shtresës.
- n) Në kohë të nxehtë, fillimisht ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit bëhet me rulo me peshë të lehtë 5 deri 7 ton dhe më pas vazhdohet me rulo me peshë 10 deri ne 12 ton, ndërsa ne kohë të ftohtë, ngjeshja fillohet me rulo te rëndë 10 – 12 ton dhe më pas vazhdohet me rulo të lehtë, shpejtësia e lëvizjes së rulit duhet të jetë në kufijtë 2 deri 4km/orë.
- o) Ngjeshja e vendeve që nuk mund të kryhen me cilindër, ngjeshen me tokmak ose pllaka të nxehta.
- p) Cilindri ngjeshës në çdo kalim duhet të shkele ne gjurmen e mëparshme jo më pak se 0.25 te gjerësisë së tij.
- q) Ngjeshja e asfaltobetonit quhet e përfunduar atëherë kur mbi sipërfaqen e asfaltuar cilindri gjatë kalimit të tij nuk lë më gjurmë.
- r) Cilindri i rulit gjatë punës për ngjashjen shtresës së asfaltobetonit duhet të lyhet vazhdimisht

me solucion solari të holluar me vajgur për të mënjeluar ngjitjen e kokrrizave të bituminuara në të.

- s) Nuk lejohet që ruli të qëndrojë në shtresën e asfaltobetonit të pangjeshur plotësisht ose të bëjë manovrim të ndryshme mbi të.
- t) Kur shtrimi i asfaltobetonit kryhet pa ndërprerje dhe përbëhet nga dy shtresa, këshillohet që shtresa e binderit të kryhet natën, ndërsa shtresa përdoruese ditën.
- u) Për të mënjeluar rrudhosjen e shtresave të asfaltobetonit në rrugët, që kanë pjerrësi gjatësore mbi 6% është e domosdoshme që të sigurohet sipërfaqe e ashpër e shtresës së asfaltobetonit duke përdorur për prodhimin e tij çakëll kokërrmadh dhe ngjeshja me cilindër të kryhet duke filluar nga pjesa më e ulët.
- v) Fugat të cilat krijohen gjatë shtrimit të asfaltobetonit në kohë të ndryshme duhet të trajtohen me kujdes të veçantë, për të mënjeluar boshllëqet që mund të krijohen në to. Këshillohet që të respektohen rregullat që vijojnë:
 - v-1) Fugat midis shtresës së binderit dhe shtresës përdoruese të asfaltobetonit duhet që në çdo rast të jenë të larguara nga njëra-tjetra në kufijtë 10 deri 20cm
 - v-2) Ndërprerjet e shtresës së asfaltobetonit në plan në drejtim tërthor me aksin e rrugës duhet të bëhet me një kënd 70° .
 - v-3) Fugat gjatësore të terthore me aksin e rrugës duhet të bëhen të pjerrëta me 45° .
Para fillimit të shtresës pasardhëse të asfaltobetonit, shtresa e mëparshme duhet të pritët me daltë duke e bërë fugën të pjerrët me kënd 45° .
 - v-4) Para fillimit të shtresës së asfaltobetonit fuga lyhet me bitum dhe në buzë të saj vendoset listelë druri, e cila kufizon trashësinë e asfaltobetonit të shkrifët dhe nuk lejon asfaltin e fresket mbi shtresën e ngjeshur më parë. Kur fillon ngjeshja hiqet listela dhe cilindri duhet të bëjë ngjeshjen duke shkelur jo më pak se 20 cm fugën. Mbas perfundimit të ngjeshjes, fuga në të dyja anët e saj në një gjerësi prej 6cm duhet të lyhet me bitum.
- w) Në rastet kur shtresa përdoruese e asfaltobetonit shtrohet mbasi shtresa lidhëse (binderi) i është nënshtruar me parë lëvizjeve të automjeteve, duhet detyrimisht të pastrohet sipërfaqja e saj nga papastërtitë e pluhuri, të mos përmbajë lagështi dhe të spërkatet me bitum të lëngshëm (në sasi deri 06 kg/m^2) para fillimit të vendosjes së shtresës përdoruese të asfaltobetonit.

***Shënim:** Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit

kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik**” i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

NJËSIA E PROKURIMIT